




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Deliverty	11.05.2021	viti god year.	
Organ (Njesia Org./Jednica Org./Unit)	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	2343/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.194/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.194/2021, të datës 26.03.2021, të parashtruar nga ankuesja [] me adresë banimi Rr."Shyqeri Haziri" nr.69, Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit/Agjencia e Punësimit - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 11.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.194/2021 e datës 26.03.2021, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja [] e punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, me datë 26.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1405/2021, të regjistruar me numër A.nr.194/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për harmonizimin e koeficientit të pagës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Këshilli, me datë 06.04.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 1405/2021 të regjistruar me numër A.nr.194/2021 në Këshillin e Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ekspertizën Financiare me numër të protokollit 1325/2020 e datës 28.02.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan; Aktvendimin e datës 03.08.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë -dega Lipjan; Ankesën me numër të protokollit 4481 të datës 07.08.2020; Diplomën me numër 748/2015 të datës 10.07.2015 të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1509/2021 të datës 31.03.2021; Kërkesën me numër të protokollit 197/2017 të datës 22.11.2017; Kërkesën me numër të protokollit 85/15 të datës 13.08.2015 për nivelizimin e pagës; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1616/2021 të datës 06.04.2021; Akt Emërimit me numër 33 të datës 28.12.2017; Kontratën e Marrëdhënies së Punës me numër të protokollit 023 të datës 31.01.2006 të ankueses; Kontratën e Marrëdhënies së Punës, me numër të protokollit 929/06 të datës 10.04.2006 të ankueses; Aktvendimi me numër Ac.nr.4473/20 të datës 25.02.2021 të Gjykatës se Apelit në Prishtinë; Emalin e datës 05.05.2021 ; Emalin e datës 30.04.2021; Aktin e Emërimit me numër 21 të datës 28.12.2017; Listën e pagave për periudhën kohore 01.04.2021 deri me 30.04.2021 për zyrtarët në Agjencinë e Punësimit; Aktin e Emërimit me numër 18 të datës 28.12.2017 të zyrtares T.B; Aktin e Emërimit me numër 14 të datës 28.12.2017 të zyrtares N.G; Aktin e Emërimit me numër 148 të datës 28.12.2017 të zyrtares F.P; Aktin e Emërimit me numër 149 të datës 28.12.2017 të zyrtarit N.H; Aktin e Emërimit me numër 142 të datës 28.12.2017 të zyrtarit K.Sh; Aktin e Emërimit me numër 70 të datës 18.12.2018 të zyrtarit D.D;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e palejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit Nr.33 të datës 28.12.2017, është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Zyrtare e Punësimit, me koeficient të pagës 5.5, pranë Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Sipas shkresave të administruara të lëndës, rezulton se ankuesja se fundi me datë 22.11.2017 ka parashtruar kërkesë të organi i punësimit, për harmonizimin e koeficientit të pagës nga pesë (5), në gjashtë pikë pesë (6.5). Sipas shkresave të lëndës, ankuesja nuk ka pranuar përgjigje me shkrim nga organi i punësimit, andaj e njëjta me datë 26.03.2021 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në nenin 50 dhe 81 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur ankuesja ka parashtruar kërkesë të organi i punësimit, ka konstatuar se nëpunësit civil i është njohur e drejta e ushtrimit të mjeteve juridike për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;* 2. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Andaj, duke marr parasysh se ankuesja, me datë 22.11.2017 ka paraqitur kërkesë për harmonizimin e koeficientit të pagës, dhe meqenëse e njëjta brenda afatit ligjor nuk ka marr përgjigje nga organi i punësimit, Kolegji vlerëson se ankuesja ka mundur të ushtroj ankesë për



heshtje administrative në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me se largu, në afat prej 2 muajsh, pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ. Në këtë kuptim, Kolegji, konstaton se ushtrimi i ankesës me datë 26.03.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.194/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së